

Qyteti im

falas



*Korça feston edhe në dimër!
Kori "Lyra", CD në dy volume
Bashkia zgjeron hapësirën e
komunikimit me qytetarët*



KORÇA KU

DUA TE JETOJ



Parakalimi i 30 babagjyshëve të vegjël ngazëllen qytetarët

Për herë të parë 30 babagjyshë të vegjël, parakaluan në bulevardet e sheshet kryesore të qytetit duke shpërndarë për të gjithë atmosferë festive. Të shoqëruar nga Kryebabagjyshi, i cili i hipur në karrocën e tij të zbukuruar si për festë, përshëndeste e uronte nën tingujt e muzikës të gjithë qytetarët, babagjyshët e vegjël mjaft gazmorë e zbatimës shpërndanë kartolinën e urimit të festave për të gjithë qytetarët, si dhe fruta e ëmbëlsira të përgatitura enkas nga Pasticëri "Dajana".

Kësaj atmosfere mjaft gazmore, e cila përfundoi tek sheshi i panairit, iu bashkuan mjaft fëmijë, të cilët të veshur me petkun e babagjyshit u ndjenë babagjysh për një ditë.

Festa u finalizua me foton e 1000 babagjyshëve në shkallët e Katedrales në qendër të qytetit.



Korça feston e



Panairi i Fundvitit 2008 i zhvilluar në qyteti e Korçës, është eksperiencia e parë në Shqipëri. Bashkia Korçë, synon kthimin e tij në traditë të përvitshme, duke e bërë Korçën qendrën e festimeve të fundvitit në të gjithë Shqipërinë.

edhe në dimër!

Gjallëruan sheshin e Panairit

Serenata Korçare
Teatri i Kukullave
Kamela Islami –Koncert live
Eneida Tarifa Koncert live
Koncert me Karolat e Krishtlindjeve
nga nxënësit e Shkollës “Tefta T.Koço”
Olsa Papandili & The Singles – Koncert live

“Korça qyteti i festave” nuk është thjesht një slogan, por pjesë e një strategjie vizionare që synon veç gjallërimit të jetës në qytet, zhvillimin e turizmit, e cila është e lidhur direkt me zhvillimin ekonomik të qytetit.



Të jesh krenar për qytetin tënd

Ekspozita e Revistës “Qyteti im”

Revista “Qyteti im”, botimi zyrtar i Bashkisë Korçë shënoi një vjetorin e daljes së saj në qarkullim. Gjatë kësaj periudhe, me spektrin e gjerë të informacionit që ofron, ajo ka qenë mjaft pranë lexuesit.

Me këtë rast, “Qyteti im” u prezantua për qytetarët me një ekspozitë të vetën, duke qëndruar e hapur për mëse një javë tek Panairi i Fundvitit.

Bashkë me të, me slloganin “Të jesh krenar për qytetin tënd” u ekspozuan edhe fotot më të bukura të përzgjedhura e të publikuara në faqet e kësaj reviste. Janë foto amatorësh, pamje mjaft impresionuese nga ndërtesat karakteristike, pamje të qytetit të Korçës, momente nga festat më popullore të zhvilluara në qytetin tonë, foto të cilat me të vërtetë të bëjnë të ndihesh krenar për qytetin tonë.

Kjo ekspozitë, është njëkohësisht një premtim i mbajtur nga stafi i Revistës “Qyteti im” për të gjithë të apasionuarit pas fotografisë, të cilët u janë drejtuar faqeve të revistës për të publikuar punët e tyre më të mira. Gjejmë rastin të falenderojmë të gjithë këta bashkëpunëtorë, duke inkurajuar edhe të tjerë, të apasionuar pas fotografisë, të dërgojnë fotot e tyre më të bukura.



Dhurata për fëmijët dhe të rinjtë jetimë

Bashkë me urimin se të gjithë fëmijët kanë të drejtë dhe meritojnë të gëzojnë, Bashkia e qytetit ka ndarë dhuratën e Vitit të Ri edhe për fëmijët dhe të rinjtë jetimë të qytetit të Korçës.

Krejtari i Bashkisë Niko Peleshi i pranishëm në ceremoninë e dorëzimit të dhuratave, premtoi se edhe vitin e ardhshëm, këta fëmijë e të rinj do të kenë përkujdesjen e Bashkisë nëpërmjet programeve të posaçme që ajo ka përgatitur.



Ta bëjmë qytetin më miqësor e më social

Ky ka qenë mesazhi i dhënë për të gjithë qytetarët nga Kryebashkiaku Peleshi gjatë takimit me 50 të moshuarit e Qendrës Komunitare në prag të Vitit të Ri. Për ta bërë më të gëzueshme tavolinën e ndërrimit të viteve, Bashkia e qytetit u dhuroi këtyre të moshuarve nga një shishe verë dhe ëmbëlsira.

Jetë të shëndetshme dhe ditë të qeta për 50 flokëbardhët e Qendrës Komunitare të Moshës së Tretë në Korçë!


Për të moshuarit e tjerë të vetmuar të qytetit, vitin e ardhshëm Bashkia Korçë do të çelë edhe 2 qendra të tjera kryesisht në periferi të qytetit, me qëllim që ato të jenë sa më afër banesës së tyre.



Mesazh emancipimi për gratë korçare

Kryebashkiaku Peleshi përcolli mesazh emancipimi për gratë korçare në prag të festave të fundvitit, duke i ftuar ato të përfshihen në jetën social-kulturorë të qytetit. Ky mesazh u materializua simbolikisht me ftësën që ai u bëri 175 grave punonjëse të një prej ndërmarrjeve më të mëdha të prodhimit të konfeksioneve në qytet (NPV International), në shfaqjen variete të teatrit profesionist. Në takimin me to, z.Peleshi vlerësoi kontributin e grave si fuqia kryesore punëtore në qytet. Ai u uroi grave një vit më të mbarë, duke ndarë për to edhe dhuratën simbolike të festave.





Lulishtet do të pajisen me stola dekorativë

Gjatë rikonstruksionit të lulishteve në qytet, del e nevojshme blerja e stolave dekorativë për mobilimin sa më bashkëkohor të tyre. Për këtë arsye, Bashkia ka siguruar blerjen e 26 stolave duke akorduar fondin prej 312 mijë lekësh. Gjatë vitit 2008 u bë një punë e konsiderueshme në sipërfaqet e gjelbra në qytet. Krahas rehabilitimit të sipërfaqeve ekzistuese të degraduara dhe shtimin e sipërfaqeve të reja, një punë e mirë u bë edhe me lulishtet ekzistuese, në të cilat krahas sistemimit u bë edhe zëvendësimi i bimësisë së degraduar me bimësi të re dekorative.

Bashkia ndërhyr duke parandaluar shembjen e krejt pallatit

Bashkia e Korçës ekzekutoi vendimin e KRRT-së për prishjen e seksionit të dëmtuar të pjesës anësore të pallatit, i cili njihet si ish konvikti i shkollës së ndërtimit duke parandaluar në këtë mënyrë shembjen e krejt pallatit dhe rrezikimin e jetës së banorëve në të. Nga ana tjetër, me një vendim të Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë mori përsipër rikonstruksionin e seksionit të dëmtuar, pavarësisht se ajo është në pronësi private. Njëkohësisht Bashkia mori masa për strehimin e përkohshëm të familjeve që u prekën nga kjo shembje deri në përfundim të punimeve.

Vendimet më të rëndësishme të Këshillit Bashkiak

1. Miratim fondi për Qendrën Ditore të Zhvillimit
2. Miratim fondi për Shoqatën e Fëmijëve Jetimë dhe të Rinve Jetimë
3. Miratim fondi për Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e vogla”
4. Miratim Fondi prej 150 mijë lekësh të reja për spitalin e qytetit për blerje medikamentesh
5. Për miratimin e Planit të Veprimit të Zhvillimit të Turizmit në qytetin e Korçës.
6. Miratim fondi për shpërndarje dhuratash për të regjistruarit e Qendrës Komunitare të moshës së tretë dhe punonjëseve të NPV International.

Shënim: për më shumë informacion rreth vendimeve të Këshillit Bashkiak do t'i drejtoheni sportelit të informacionit në Bashki.

“Kripmjaltëzat në Korçë”



Mbrëmja Qëndrore këtë vit vjen ndryshe

Për më të mirët e shkollave 9-vjeçare, Mbrëmja Qëndrore erdhi këtë vit mjaft e veçantë. Kanë qenë Kripmjaltëzat, të cilët argëtuan bashkëmoshatarët e tyre nëpërmjet shfaqjes surprizë të organizuar nga Bashkia e qytetit.

Për më shumë se një orë, nxënësit e shkëlqyer të shkollave 9-vjeçare të qytetit, të shoqëruar nga prindërit e tyre, kënduan e vallëzuan së bashku me Kripmjaltëzat, këngët, vallet e fabulat e interpretuara me humor prej tyre. Bashkë

me urimin: “Gëzuar dhe suksese në vitin e ardhshëm”, këta nxënës morën nga Bashkia dhuratën e çmuar të Mbrëmjes Qëndrore, dhuratën e më të mirëve.

“Dua që kur fëmijët marrin një dhuratë, të mendojnë se si ta kthejnë atë me më shumë përkushtim e rezultate të mira në mësim”, - u është drejtuar fëmijëve Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi, i cili ndoqi bashkë me këta nxënës në sallë shfaqjen e Kripmjaltëzave.

Dhurata dhe një vit sa më i shëndetshëm për fëmijët e Spitalit Pediatrik

Edhe fëmijët e sëmurë, të shtruar në Spitalin Pediatrik të qytetit nuk qëndruan jashtë vëmendjes së Bashkisë Korçë.

Menjëherë pas shfaqjes në Mbrëmjen Qëndrore, Kripmjaltëzat shoqëruan Kryetarin e Bashkisë në Spitalin Pediatrik, duke ndarë edhe për ta dhuratën e Vitit të Ri. Krahas urimit Gëzuar, Kryetari Peleshi iu ka uruar këtyre fëmijëve një vit sa më të shëndetshëm.



Më të mirëve të shkollave 9-vjeçare u rezervohet një pritje nderi në Bashkinë e qytetit



14 nxënësit më të mirë, përfaqësuesit e 14 shkollave 9-vjeçare të qytetit u pritën në një takim të veçantë nga Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi. Në këtë takim, Kryetari Peleshi i përgëzoi dhe i falenderoi këta fëmijë për rezultatet e larta të arritura në procesin mësimor. Ata janë jo vetëm krenaria e prindërve dhe e shkollës, por krenaria e qytetit.

Pasi iu uroi suksese të mëtijshme për vitin e ardhshëm shkollor, ai kërkoi që fëmijët të argëtohen sa më shumë me festat e organizuara nga Bashkia në këtë fundviti.



Komplete sportive për nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Demokracia”

Bashkia Korçë më ndihmën e UNICEF dhe “Terre des Hommes” ka dhuruar komplete sportive për 425 nxënësit e Shkollës Fillore “Demokracia”. Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi i cili ndau uniformat për këta nxënës, premtoi se Shkolla “Demokracia”, pavarësisht se është shkollë periferike ajo do të jetë në qendër të vëmendjes së Bashkisë së qytetit. Njëkohësisht një tjetër premtime, ishte edhe akordimi i një fondi për rrethimin e plotë të kësaj shkolle.



“Artistët e vegjël” të qytetit, në rrugë të mbarë

Fëmijët korçarë të cilët prej disa muajsh ndjekin kurset “Artistët e vegjël” të çelura nga Bashkia Korçë, kanë demonstruar aftësitë e mara në një program artistik në prag të festës së Vitit të Ri .Ekspozita me punët e nxënësve të kursit të fotografisë, vizatimit dhe poçerisë u pasua dhe nga një koncert i kitaristëve të vegjël dhe nxënësve të kursit të baletit.Këto kurse janë çelur disa muaj më parë me iniciativën e Bashkisë Korçë në kuadër të programit “Qyteti për fëmijët”.Duke i parë ato si një mundësi jo vetëm për kalimin e kohës së lirë por edhe si një vend ku fëmijët ushtrojnë dhe përsosin talentet e tyre ,Bashkia Korçë do të kujdeset për mbarëvajtjen e këtyre kurseve edhe në vitin 2009 duke synuar institucionalizimin e tyre.

Vogëlushët “cicërojnë” mbi telajo

Edhe këtë vit ekspozita e fundit e çelur në Qendrën Kulturore “Vangjush Mio” të qytetit ka patur autorësinë e fëmijëve .Nën titullin “Cicërima mbi telajo”fëmijët e talentuar të kopshteve të qytetit kanë ekspozuar punët e tyre më të mira .



Të rinjtë gjatë trajnimit

Starton projekti “Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj”

Me synimin kryesor, zhvillimin ekonomik të qytetit si dhe në kuadrin e një prej programeve më kryesore të Bashkisë “Qyteti mbështetë të rinjtë”, Bashkia Korçë inicioi projektin YEP - “Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj”, që synon inkurajimin e iniciativave sipërmarrëse tek të rinjtë, përballjen e tyre me tregun e punës si dhe krijimin e një rrjeti që do të kontribuojë në lehtësimin e punësimit të të rinjve.

Projekti bashkëimplementohet me organizatën CAAP -Aksione të koordinuara kundër varfërisë dhe mbështetet nga Terre des Hommes dhe USAID.

Pas regjistrimit të aplikantëve gjatë muajit nëntor (të rinj 20-30 vjeç, të papunë), më 16 dhe 17 dhjetor u zhvilluan trajnimet e para orientuese.

50 të rinjtë e përzgjedhur morën njohuritë e para mbi sipërmarrjen, nëpërmjet seancave të trajnimit “Making sense” si dhe vizituan

biznese dhe organizata që operojnë në tregun e Korçës. Konkretisht të rinjtë vizituan Agjensinë Rajonale për Zhvillim-ARZH, organizatën SNV, Birra Korçën dhe sallameri Fix.

Në janar do të zhvillohen trajnimet specifike mbi sipërmarrjen dhe tregun e punës.

Rezultatet e pritshme të projektit:

- Rritja e vetëbesimit, aftësive sipërmarrëse, si dhe aftësive për t'u përballur me tregun e punës tek 50 të rinjtë e trajnuar
- Hapja e 10 bizneseve të reja, që do të përfitojnë një grant prej 130.000 Lekësh, tarifë regjistrimi 0, si dhe 30% ulje në taksat dhe tarifat vendore gjatë vitit të parë të aktivitetit.
- Punësimi i 20% të të rinjve pjesëmarrës në projekt



Kliko www.bashkiakorce.gov.al



← Çfarë ju ofrojmë

- Gjithçka për qytetin e Korçës (histori, turizmi, bizneset, institucionet, harta, shërbimet)
- Shërbimet e Bashkisë Korçë
- Programet mbi të cilat Bashkia punon
- Aktivitetet
- Lajmet më të fundit
- Publikimet e Bashkisë Korçë (Të gjitha botimet e gazetës zyrtare "Qyteti im")
- Njoftime
- Opinions të qytetarëve
- Mundësi për të na shkruar e kontaktuar me e-mail



Terminali në hyrje të Bashkisë



Tashmë të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë të njihen më mirë qytetin e Korçës, apo ju nevojitet të vjelin më shumë të dhëna rreth punës së Bashkisë Korçë dhe shërbimeve që ajo ofron, mund të përdorin terminalin e vendosur në hyrje të Bashkisë. Nëpërmjet tij qytetarët do të kenë mundësi të aksesojnë faqen e Internetit të Bashkisë si dhe informacione të ndryshme që ndodhen në serverin e saj. Terminali është pjesë e programit 24/7 të Bashkisë Korçë që do të thotë se terminali ofron informacion 24 orë në 7 ditë të javës. Nëpërmjet tij synohet përmirësim të komunikimit të Bashkisë me qytetarët si dhe rritja e popullaritetit dhe nevojës për përdorimin e internetit.



Supplement



HISTORIKU

Korit Lyra në ditët e sotme

Korit "Lyra", ky emër kaq i vjetër përmban në vetvetë thesarin e këngëve të qytetit duke u bërë simbol i këngës qytetare korçare. Korit "Lyra" është formuar rreth viteve 1917 – 1922 si vazhdim i formacioneve instrumentale – korale dhe i grupeve të asaj kohe "Djelmëria korçare" dhe Korit të Ushtrisë. Në shtypin e kohës thuhet se koncertin e parë ky grup koral e dha bashkë me Bandën "Vatra" në palestrën e qytetit më 22 tetor 1922, datë e cila u quajt nga populli korçar si dita e themelimit të këtij grupi. Pas vitit 1928 drejtimin e këtij grupi e mori profesori i ri i muzikës Sotir Kozmo, i cili kishte mbaruar studimet e larta në Konservatorin e Bukureshtit. Ai si profesionist punoi për rritjen e cilësisë së grupit, por ka edhe meritën sepse ngriti të parin grup koral me vajza në qytetin e Korçës. Meritën kryesore në këtë zhvillim e kishte rinia korçare si dhe ata që shkruan tekstat e këngëve dhe kompozuan muzikën për to siç janë Mihal Grameno, Thoma Nasi, Spiridon Ilo, Koli Rodhe, Mihal Ballkameni dhe shumë të tjerë të cilët kanë mbetur anonimë. Gjatë këtyre 83 viteve

të ekzistencës së tij, grupi ka ekzekutuar më shumë se 200 këngë patriotike, lirike dhe satirike të trevës së Korçës. Vlen të theksojmë se në ngritjen e emrit të Korit "Lyra" kanë influencuar edhe koncertet e përbashkëta me artistët e mirënjohur si Tefta Tashko Koço, Kristaq Antoniu, Jorgjia Filce, Gaço Çako si dhe me pianistet e njohura, Lola Gjoka dhe Karmen Nako. Pas vitit 1944 "timonin" e grupit e mori Kristaq Osmanlli i cili u largua në vitin 1979. Që prej këtij viti, drejtimin e grupit e mori dirigjenti Jorgaq Nano "Artist i merituar", i cili po drejton me aftësi dhe kompetencë profesionale edhe sot.



Fillimet e Korit "Lyra"

KORI “LYRA”-PASURI KULTURORE E KORÇËS

Bisedë me Jorgaq Nanon

Qyteti im - Kur daton krijimi i Korit “Lyra”?

Gaço Nano - Tradita korale në qytetin e Korçës ka qënë e hershme .Të paorganizuar grupet korale kanë filluar aktivitetin e tyre që para vitit 1920, madje që në vitet 1908 -1909 atëherë kur u formuan edhe bandat e para në qytetin e Korçës. Më pas u krijua një shoqëri që quhej “Shoqëria e arteve të bukura”. Pjesë e kësaj shoqërie ishin grupe korale, një bandë, formacione teatrale etj. Por megjithatë, grupet korale që ekzistonin në këto vite, ekzekutonin lloje të ndryshme këngësh qytetare dhe klasike. Në vitin 1927 u krijua shoqëria “Djelmëria korçare” e drejtuar nga Sotir Kozmo. Më vonë në vitin 1928 krijohet shoqëria kulturore “Lyra”. Por, nga të dhënat e kohës, mqs pjesa më e madhe e koristëve kanë qënë pjesë e këtyre grupeve kulturore, si vit i krijimit të Korit “Lyra” përcaktohet viti 1922.

Qyteti im - Cilat ishin faktorët që favorizuan krijimin e shoqërive kulturore dhe koreve në qytetin e Korçës? Pse këtu ky fenomen spikati ndryshe nga qytetet e tjera?

Gaço Nano - Në vitet kur këto grupe u krijuan, Korça ka patur shumë emigrantë, të cilët sollën kulturën e vendeve ku emigronin si edhe të huaj që jetonin në qytet, për shembull profesorët e Liceut Francez një pjesë e të cilëve kanë marrë pjesë edhe në formacionet orkestrale dhe korale të kohës. Kjo prurje kulturore e eksperiencës perëndimore ka patur një ndikim të padiskutueshëm dhe të ndryshëm nga qytetet e tjera.

Qyteti im - Repertori i korit ka patur gjithmonë të njëjtin linjë apo në kohë të ndryshme ka patur fizionomi të ndryshme? Përgjithësisht kanë qënë këngë të krijuara apo edhe këngë të përkthyer a të përshtatura?

Gaço Nano - Ka këngë të krijuara nga Thoma Nasi, ka edhe këngë që janë të përshtatura mbi bazën e melodive të huaja ballkanike kryesisht, por edhe franceze. Repertori i korit numëron sot 120 këngë përfshi këtu këngët lirike, patriotike, satirike veç këngëve partizane që janë përsëri në repertorin e korit si edhe këngëve të interpretuara në gjuhë të ndryshme si greke, maqedonase, kosovare, rumune, ruse, gjermane si edhe këngët popullore por edhe ato fetare të karakterit bizantin të interpretuara nga kori .

Qyteti im - Në rreth 80 vjet ekzistencë, cili ka qënë roli i Korit “Lyra” në jetën social-kulturore të Korçës dhe sa ka përfaqësuar kori kulturën muzikore të qytetit në Shqipëri e më gjerë?

Gaço Nano - Në fillimet e tij kori këndonte në festa të ndryshme familjare, por sigurisht edhe në kocerte të organizuara në Teatër dhe Pallatin e Kulturës, në qendra të ndryshme pune por edhe në turne jashtë shtetit. Në vite ai e ka konsoliduar profiling e vet si pjesë identifikuese e kulturës korçare.

Qyteti im - Si u bashkuan një grup korçarësh të talentuar dhe të apasionuar pas muzikës në një kor?

Gaço Nano - Një fakt është i njohur për Korçën. Po u bashkuan dy korçarë këndojnë me dy zëra, po u bashkuan tre këndojnë me tre zëra ,me pak fjalë e kanë traditë, e kanë kulturë, e kanë në natyrën e vet këngën dhe të kënduarin në grup. Kështu u bashkuan 12 zërat më të mirë të asaj kohe mes të cilëve Gaço Jorganxhi, Tole Adhami, Niko Ilo, Vaskë Xherahu etj .Këta, së bashku me instrumentistë si Niko Cavali , Kostaq Kota në kitarë ,dirigjentin Kostaq

Osmanlli krijuan një grup të konsoliduar .

Qyteti im - Cilët kanë qënë disa prej drejtuesve të korit “Lyra” në vite?

Gaço Nano - Drejtuesi i parë ka qënë Ilo Mosko që ka marrë pjesë edhe në “Shoqërinë e arteve të bukura” më pas kori është drejtuar nga Kristo Kono , Sotir Kozmo, Kostaq Osmanlli dhe i fundit i kësaj stafete muzikore jam unë .

Qyteti im - Çfarë do të thotë për ju që prej 30 vjetësh drejtoni një kor që është vlerë identifikuese e kulturës korçare?

Gaço Nano - Unë kam 42 vjet eksperiencë në drejtimin e koreve pasi para Korit “Lyra” kam drejtuar Ansamblin e qytetit të Korçës . Nuk jam lodhur fare, referuar faktit që kam punuar gjithmonë me këngëtarë të mrekullueshëm dhe kjo më bën të jem po aq energjik sa në fillimet e mija me këtë kor.

Qyteti im - Cilat kanë qënë veglat muzikore që kanë shoqëruar në vite korin dhe a ka patur pasurim në këtë drejtim?

Gaço Nano - Në fillim këngët e korit shoqëroheshin nga mandolina dhe kitarat.Në vitet 1927 filloi të futej në shoqërim pianoja dhe violina ndërsa për shumë vite me rradhë vazhdoi me formacionin baze kitarë, mandolinë më pas unë e kam pasuruar edhe me flaut, fizarmonikë dhe kondrabas .

Qyteti im - Kur datojnë regjistrimet e para të korit ? A ka arkiva inçizimesh dhe filmimesh nga aktiviteti i Korit “Lyra” në gjithë këto vite?

Gaço Nano - Regjistrimet e para janë bërë në Radio Tirana midis viteve 1950-1955. Në vitin 1981 është bërë regjistrimi i parë televiziv nga TVSH . Më pas ka regjistrime të bëra nga televizione të ndryshme, të cilat janë fragmentare dhe të shpërndara. Por regjistrimi i parë i saktë dhe i kompletuar janë dy CD me nga 13 këngë të punuara nga Eduard Dashi inicuar nga Qendra Kulturore “V.Mio” dhe mbështetur nga Bashkia Korçë .

Qyteti im - Sa e rëndësishme është ekzistenca e Korit “Lyra” për Korçën dhe sa optimist jeni për jetëgjatësinë e tij?

Gaço Nano - Më parë kori kishte 33 vetë dhe çuditërisht vazhdon me këtë formacion sepse jam përpjekur që të bëj zëvendësime sa herë që dikush largohet për shkaqe natyrore apo të tjera .Kështu që jam optimist për vazhdimësinë e tij edhe në të ardhmen. Kori “Lyra” është një vlerë e qëndrueshme e kulturës së qytetit të Korçës.

Jorgaq Nano Dirigjent, Artist i Merituar

Jorgaq Nano ka përfunduar studimet në Institutin e Lartë të Arteve, në Degën Teoritik. Ai ka drejtuar grupe artistike në qytetin e Korçës qysh prej vitit 1968 dhe që prej vitit 1979 e deri më sot, ai është dirigjent i Korit “Lyra”. Është nderuar me Urdhërin “Naim Frashëri” të Kalsit I,II,III dhe në vitin 1991 i jepet Titulli “Artist i Merituar”. Në qershor të 2008-ës Bashkia Korçë e vlerësoi me Titullin “Protagonist 2007” mes 11 artistëve më të mirë korçarë të këtij viti.

Vështrim në Kohë

Vijon nga numri i kaluar...

DHIMITËR ZOGRAFI (1878 – 1945)

Lindi në Korçë. Në fund të shekullit XIX së bashku me vëllezërit emigroi në Rumani. Më 1906 merr pjesë në themelimin e shoqërisë patriotike të shqiptarëve të Bukureshtit “Bashkimi-Unirea”. Një nga organizatorët e mbledhjeve që u zhvilluan në fillim të nëntorit 1912 në Bukuresht. Aty theksoi se patriotët “kanë besim të plotë në veprimin e Kombit shqiptar pas udhës që tregoi z. Ismail Qemal Beu e se kanë për të bërë sa mundet me gjithë shpirt e me të gjitha mënyrat për shpëtimin e Atdheut” (“Shqipëri e Re”, Kostancë, datë 29 nëntor 1929). U zgjodh delegat i kolonisë shqiptare të Bukureshtit për të marrë pjesë në Shpalljen e Pavarësisë. Më 28 nëntor 1912 firmos vendimin e Pavarësisë me siglën “Dimitri Zografi”. Anëtar i pleqësisë. Në dhjetor 1912, bashkë me Dhimitër Emanoilin, shkon në Brindisi e prej andej kthehet në Korçë nga ku largohet më 1917. Kundërshton vendimet e padrejta të Konferencës së Parisit në kurriz të popullit shqiptar dhe firmos protesta drejtuar kryesisë së saj në qershor 1919. Vdiq në Bukuresht.



PANDELI CALE (1879 – 1923)

Lindi në Korçë. Kreu liceun klasik francez të Aleksandrisë në Egjipt. Në vitet 1900-1904 punon në koloninë e Bukureshtit. Më 1904 kthehet në Shqipëri. Bashkë me Themistokli Gërmenjin dhe Mid'hat Frashërin vuri bazat e Komitetit të Fshehtë Shqiptar në Selanik. Kryetar i shoqërisë “Banda e Lirisë” më 1908. Në shkurt 1909, sekretar i shoqërisë “Lidhja orthodhokse”. Në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1910 – 1912 drejtoi çetat e zonës së Korçës. Merr pjesë në mbledhjen e 5 nëntorit 1912 dhe si vetëdëshës shoqëron Ismail Qemalin për në Shqipëri. Më 28 nëntor 1912, si delegat i Korçës, firmos manifestin e pavarësisë me siglën “Pandeli Cale”. Emërohet Ministër i Bujqësisë, lindiutrisë dhe Tregëtisë. Vitet e Luftës së Parë Botërore i kalon në Zvicër, Ukrainë, Bullgari, Francë. Më 1919 kthehet në atdhe. Më 1920 hartues dhe firmëtar i Protokollit të Kapshticës. Më 1920 Prefekt i Korçës. Në shkurt 1921 deputet në të parin parlament shqiptar. Vdiq i sëmurë në një spital të Selanikut.



SPIRIDON ILO (1876 – 1950)

Lindi në Korçë. Mësues në shkollën shqipe të vashave. Emigroi në Bukuresht ku u lidh me koloninë shqiptare të atjeshme. Në dhjetor 1909 luan një rol në dramën “Besa”. Mori pjesë mbledhjen e Bukureshtit. Thuhet se Spiridon Ilo solli flamurin shqiptar që u ngrit në Vlorë. Në mbledhjen e 28 nëntorit, si përfaqësues i Korçës, firmosi aktin e pavarësisë me siglën “Spiro T. Ilo”. Në vitin 1913 u kthye në Rumani. Në vitin 1916 emigroi në Neë York ku vazhdoi veprimtarinë patriotike. Themeloi shoqërinë e parë diskografike Albanian Phonograf Records në vitin 1923. Regjistroi për herë të parë himnin tonë kombëtar. Kallëpet e pllakave i solli në Shqipëri dhe më 1946 ia dhuroi Komitetit Ekzekutiv, por ato fatkeqësisht u shpërdoruan dhe meqë ishin prej bakri u futën në bazamentet e antenës së Radio Korçës. Veprimtarinë e tij patriotike e vazhdoi më pas në Rumani. Më 1926 u vendos përfundimisht në Korçë. Më 1938 anëtar i Dhimgogjerondisë. Më 1 prill 1945 iu akordua pension si Patriot i Rilindjes Kombëtare. Në vitet '20 botoi e shpëndau kartolina me temë patriotike. Ka botuar komedinë “Vërtet ëndërr” si dhe përmbledhjen me këngë patriotike “Dëshirat e zemrës”. Vdiq në Korçë.



Shënim: Të dhënat historike dhe hipotezat e paraqitura në këtë artikull, nuk prezantojnë një qëndrim zyrtar të stafit të gazetës.

Përgatiti: Niko Kotherja

Burime:

LIBRAT:

- “Fjalori enciklopedik shqiptar”, Tiranë, 1985
- “Korça, në faqet e historisë”, Emin Selenica
- “Një faqe historike”, Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
- “Korça - urbanistika, arkitektura”, Pirro Thomo
- “Mbi themelimin e Korçës” (broshurë) Arben Gjata
- “Shqipëria më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
- “Shqipëria e ilustruar më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
- “Korça dhe fshatrat përfaqar”, Nuçi Naçi, Sofje, 1901
- “Korça dhe katundet e qarkut” (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
- “Historia e Shqipërisë” vëll. II, Tiranë 1965
- “Themistokli Gërmenji”, Pirro Tako, Tiranë, 1988

Monumente Kulture



Banesa e Zengove

Banesa e Zengove është ndërtim i Periudhës së Rilindjes. Është shpallur Monument Kulture në vitin 1963 dhe ndodhet sot në Rruga “Kryengritja e Qershorit”, Nr 3.

Godina e Zengove është e përbërë nga dy pjesë, një seksion është i banueshëm nga trashëgimtarët e familjes Zengo dhe pjesa tjetër që quhet Mysafirhanja, është pjesa e godinës e cila ruhet si Monument Kulture.

Godina është 3 katëshe. Kati i parë i kësaj ndërtesë është i ndërtuar i gjithi me gurë shtufi. Gurët kanë forma të rregullta rradhore, të punuara me fugatura e relief nga jashtë, gjë e cila është një karakteristikë e veçantë e kësaj godine, pasi ndërtesat e tjera të këtij stili e kanë relievin nga brenda. Një tjetër karakteristikë e kësaj banese, është fakti se kati i parë i saj nuk është përdorur asnjëherë si banesë por si ambient shërbimi, në të cilin vendoseshin zajretë, mjetet e punës etj. Ky kat komunikon me dy katet e tjera nëpërmjet shkallëve të brendshme të cilat janë prej druri.

Dy katet e tjera janë me çatmë, pra mur druri i suvatuar. Kati i dytë, duke qenë i ngrohtë përdorej si vend për të banuar zakonisht në stinën e dimrit. Në dhomën kryesore, ashtu si në katin e tretë, ka nga një oxhak për ngrohjen me dru zjarri. Oxhaku dallohet për dekoracione butaforike me rifiniturë.

Përsa i përket stilit, në pamjen e jashtme, kati i tretë dallon nga dy katet e tjera. Ai ka shumë dritare, një element ky eklektik perëndimor, i huazuar. Ky kat, ka të zhvilluar një kënd, kryesisht për mysafirët, i cili shtrihet në të gjithë gjatësinë e banesës, në korridor dhe në dhoma. Këndi është një pjesë gati 40 cm më e lartë se dyshemeja, në të cilin vendoseshin mysafirët dhe shërbente për t'i nderuar ata dhe më së shumti për t'u krijuar atyre më shumë fushëpamje për të soditur ambientin nga brenda.

Banesa e Zengove i është nënshtruar 2 restaurimeve. E para ka qenë në vitin 2006 në të cilin është restauruar çatia, ndërsa në vitin 2007 u restauruan dritaret dhe fasada e jashtme. Njëkohësisht u hoqën fashat e vjetra prej druri dhe u zëvendësuan me të reja duke ruajtur elementët e stilit dhe materiali bazë.



Ekspozitë nga koleksionistët korçarë

Në datën 5 dhjetor, nën kujdesin e Qendrës Kulturore “Vangjush Mio”, koleksionistët korçarë ekspozuan veprat e artit që ruajnë në koleksionet e tyre personale, në ekspozitën e dytë të çelur pranë Galerisë “Guri Madhi”. Çelja e kësaj ekspozite ishte një mundësi shumë e mirë për artdashësit e këtij qyteti të kulturuar, për të shijuar magjinë e artit të derdhur në vepra me vlerë të artistëve shqiptarë e të huaj. Këto koleksione së bashku me veprat e shumta të artit që ruhen në Galerinë “Guri Madhi” përbëjnë një thesar të çmuar të trashëgimisë kulturore të qytetit tonë.

Artistë nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia marrin pjesë në Konkursin “Vangjush Mio”

40 artistë figurativë nga mbarë trevat shqiptare, morën pjesë në Konkursin Mbarëkombëtar nën titullin “Vangjush Mio” të organizuar këtë fundviti nga Bashkia e qytetit.

Mbrëmjen e së shtunës, në datën 20 dhjetor, në Galerinë e Arteve “Guri Madhi” pranë Qendrës Kulturore, u çel ekspozita me punimet më të mira të artistëve pjesëmarrës, piktorë e skulptorë, ku në praninë e mjaft të ftuarve e artdashësve të shumtë të qytetit, pedagogu i pikturës në Akademinë e Arteve Fatos Kola, në cilësinë e Kryetarit të Jurisë, ndau çmimet për më të mirët. Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve ishte prezent Kryetari i Bashkisë së Korçës Niko Peleshi.

Me çmimin e parë në pikturë u nderua Gentian Zeka ndërsa në skulpturë Vladimir Kaçaku. Me çmim të dytë u nderuan piktori Ritvan Alliti dhe skulptori Aurel Bala dhe me çmime të treta u vlerësuan piktori Nikolin Ivanaj dhe skulptori Muharrem Sadiku.

Veprat e paraqitura si peisazhe, natyra të qeta, portrete dhe kompozimet, spikatën për larmishmërinë e stileve e teknikave të përdorura.

Ekspozita qëndroi e hapur për artdashësit deri në fund të muajit dhjetor.

Dy piktorë korçarë ekspozojnë në Austri

Nga data 5 deri 8 dhjetor, në Galerinë e artit të qytetit Ëölsberg të Austrisë, piktorët korçarë Genti Proko dhe Romeo Kallço ekspozuan punët e zgjedhura nga krijimtaria e tyre. Kjo ekspozitë u çel me një ftesë të Bashkisë së Ëölsbergut e binjakëzuar prej disa vitesh me Bashkinë e Korçës. Veprat e piktorëve korçarë u vlerësuan nga kritikë dhe artdashës austriakë.

Autoritetet lokale të Bashkisë së Ëölsbergut u shprehën të hapur për bashkëpunime edhe në të ardhmen dhe jo vetëm në fushën e artit.



Koncert i Pax Dei për herë të dytë ne Korçë

Në mbrëmjen e Krishtlindjes, Kori "Pax Dei" dhuroi një koncert special për të ftuarit e kësaj mbrëmje. I organizuar nën kujdesin e Bashkisë Korçë dhe me mbështetjen e Agjencisë së Udhëtimeve L.A Travel, koncerti u mbajt në hollin e Katedrales "Ringjallja e Krishtit" nën drejtimin e mjeshtres Suzana Turku Kashara. Koncerti celi siparin me "Silent Night"- Kënga e Krishtlindjeve, për të vijuar me pjesë të zgjedhura nga klasikët botërorë Vivaldi, Shubert, Bizet etj. Në repertor nuk munguan edhe këngët tipike ruse e tre këngë amerikane si dhe mjaft këngë shqiptare. Në përfundim të programit me "Felis Novidad" Kori "Pax Dei" u uroi korçarëve "Gëzuar festat!"



Rikthehet Miss Korça



"Miss Korça Lorela Tuke"

17 vjecarja Lorela Tuke nxënëse në shkollën e mesme "Themistokli Gërmenji" u shpall Miss Korca për vitin 2008. Konkursi u rikthe pas një ndërprerje disa vjecare me qëllim evidentimin e vlerave të bukuri së korcare. Për Bashkinë Korçë e cila e mbështeti organizimin e këtij konkursi bukurie, vajza që mban kurorën Miss Korca 2008 do të jetë imazhi i disa prej aktiviteteve dhe festive të Bashkisë për vitin 2009.

Trioja Kotelli, Bello, Lulo në një koncert për artdashësit e muzikës së dhomës

Ditën e diel, në datën 21 dhjetor, në sallën e koncerteve të Qendrës Kulturore "V.Mio", për artdashësit e muzikës së dhomës, trioja Entela Kotelli në piano, Eliza Bello në violinë e Ilia Lulo në flaut dhanë një koncert. Në program bënin pjesë veprat e klasikëve botërorë Quantz, Rahmaninov, Senevil, Doppler, Honeger, Andreisen e Bach.

Shfaqja variete e fundvitit në Teatrin "Çajupi"

Trupa e estradës së Korçës, përcolli për artdashësit urimin e festave të fundvitit nëpërmjet shfaqjes variete. Në qendër të saj, humoristët Alban Prodani, Zamira Kita e A Çausi, e përcollën urimin e tyre nëpërmjet kartolinave humoristike të përgatitura nga Naum Tërova. Ndërkohë orkestra e këtij teatri, nën drejtimin e Adrian Jorgjit shoqëroi live këngëtarët Laxarela, Mateus Frroku dhe këngëtarë të rinj. Varieteja e fundvitit u shoqërua edhe me kërcime ritmike të grupit të koreografit Jonel Asabella.

JAVA E KINEMASË SPANJOLLE

Nga data 6 deri në 11 Tetor 2008

Ora : 19.00

Kinema "Majestic Milenium" – Korçë

HYRJA është e lirë

filmat do të shfaqen në versionin original me titra në anglisht dhe shqip



Ditët e filmit spanjoll në Korçë

"Kaleidoskopi Spanjoll" çeli siparin në mbrëmjen e së hënës, në datën 1 dhjetor, në Kinema Milenium të qytetit të Korçës. "Ditët e filmit spanjoll" u organizuan në kuadër të aktiviteteve të "Vjeshtës Kulturore Spanjolle 2008" nga Ambasada e Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit të Korçës. Synimi i përbashkët ishte njohja dhe afrimi i kulturës dhe kinemasë bashkëkohore spanjolle pranë publikut të Korçës.

Për tre ditë me rradhë, publiku korçar pati mundësinë të ndjekë falas, në versionin original, me titra në shqip dhe në anglisht, një sërë filmash, arritjet më të mëdha të kinematografisë së sotme spanjolle.



Mitropoliti i Korçës Johani, vlerësohet nga Bashkia me Titullin “Qytetar Nderi”

“Vlera e dhuratës nuk qëndron tek ajo, por tek dhuruesi. Gjithsejçili prej nesh është thirrur jo për të bërë vepra të mëdha, por për të bërë diçka me vlerë për qytetin e tij”
Johan Pelushi

Mitropoliti i Dioqezës së Korçës Johan Pelushi, drejtuesi shpirtëror që i ka shërbyer me përkushtim zotit dhe lartësimit shpirtëror të njerëzve, u nderua nga Këshilli Bashkiak i qytetit të Korçës me titullin e lartë “Qytetar Nderi i Korçës” me motivacionin: “ Për merita të shquara në ringjalljen e besimit ortodoks, për vepra të shumta në fushën humane e sociale”. Titulli iu dorëzua nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak Raimonda Nase në një ceremoni të organizuar në Qendrën kulturore “V.Mio” të qytetit, në praninë e klerikëve e përfaqësuesve më të lartë të besimeve të ndryshme fetare, përfaqësuesve të pushtetit lokal, intelektualëve, besimtarëve e miqve të shumtë. Mitropoliti Johan cilësohet si faktor paqeje, humanizmi, vëllazërimi e miqësimi në shërbim të të gjithë shqiptarëve. Në fjalën e rastit, Kryetari i Bashkisë Korçë Niko Peleshi, e cilësoi dhënien e këtij titulli si një rast të veçantë, sepse apelon fort për t’i kthyer sytë tek vlerat shpirtërore, vlerat humane, për t’u bërë më të përgjegjshëm drejt së nesërme.

Ambasadorja e Izraelit Arnon viziton Korçën

Ambasadorja e Ambasadës së Izraelit në Shqipëri, Amira Arnon zhvilloi një vizitë zyrtare në Bashkinë e Korçës. Gjaatë bisedës së zhvilluar me Kryetarin e Bashkisë Niko Peleshi, ajo u njoh me zhvillimin ekonomik dhe me potencialet e qytetit të Korçës. Njëkohësisht biseda u orientua në drejtim të gjetjes së mundësive të bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

Ambasadorja izraelite Arnon, pasi vlerësoi arritjet e Bashkisë dhe progresin në zhvillimin e qytetit, tregoi interes për eventet e organizuara nga Bashkia e Korçës, siç janë Festivali i Karnavaleve apo edhe Festa e Birrës, duke u angazhuar për pjesëmarrjen e grupeve e firmave izraelite në këto evente.

Nga ana e tij, Kryebashkiaku i Korçës Niko Peleshi vlerësoi të rëndësishme krijimin e partnershipeve të reja për zhvillimin e rajonit të Korçës.

Ambasadorja e Ambasadës së Izraelit në Shqipëri, Amira Arnon, ftoi Kryetarin Peleshi të marrë pjesë vitin e ardhshëm në Konferencën Ndërkombëtare të Kryebashkiakëve, e cila zhvillohet çdo vit në Izrael.



Xhamisë së Iliaz Bel Mirahorit i kthehet minareja

Në prag të festave të fundvitit, besimtarëve muslimanë u kthehet minareja e Xhamisë “Iliaz Bej Mirahori”.

Ky moment u cilësua nga të gjithë si një ngjarje historike jo vetëm për besimtarët muslimanë, por për të gjithë qytetin për vlerat historike dhe arkitektonike që mbart ky objekt kulturi, i cili është Monument Kulturor dhe si i tillë, është pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës.

Kryetari i Bashkisë së Korçës Niko Peleshi, i pranishëm në këtë ceremoni u shpreh se ngritja e minaresë plotëson dëshirat e hershme të besimtarëve muslimanë, së bashku me ngritjen e saj lartësohet edhe shpirti i njeriut. Xhamia e Iliaz Bel Mirahorit është simbol i Korçës dhe si e tillë ajo i kalon vlerat e një objekti të thjeshtë kulturi. Me të, Korçës i rikthehet një tjetër atraksion turistik.



Korça ku dua të jetoj



Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë, kjo është mundësia jote.
Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh krenar për të.

Në ju ftojme të gjithëve të dërgoni foto nga ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta shihni.
Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen në faqet e “Qyteti im” dhe në fund të vitit, ju do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjidhet fotoja e vitit.

Të jesh krenar
për qytetin tënd!

Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe një përshkrim të shkurtër të fotos dhe pse e keni zgjedhur pikërisht atë.

Fotoja e muajit: Goooooool...

Komenti: Ekipi i futbollit “Skënderbeu” duhet të ketë sa më shumë momente të tilla... Për tifozët e tij dhe për qytetin.

Autori: Gjergji Polena





SPORTI PER TE GJITHE



Një foto ndryshe me ekipin e gjimnastikës

Të veshura me uniformën e tyre, pa harruar edhe kupën e fituar këtë vit në Kampionatin Kombëtar të Gjimnastikës, vajzat korçare ekipit të gjimnastikës, në prag të festave të fundvitit, u pritën nga Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi. Kryebashkiaku përgëzoi vajzat e ekipit dhe trajneren e tyre

për pasionin, mundin dhe rezultatet e larta të arritura në këtë sport të vështirë.

Bashkia,-theksoi z.Peleshi,-do të ndihmojë për të stimuluar këtë sport me traditë në qytetin e Korçës

Bashkia ... një vesh që dëgjon

Kryetari i Bashkisë Korçë Niko Peleshi takoi një grup nxënësish të shkollës 9-vjeçare "Sotir Gurra" në qytetin e Korçës. Të shoqëruar nga mësuesi i Edukimit Fizik, nxënësit e njohën Kryebashkiakun me shqetësimin e tyre për kushtet e papërshtatshme të palestrës

së shkollës. Kryebashkiaku Peleshi, duke e cilësuar si të drejtë shqetësimin e fëmijëve si dhe duke vlerësuar iniciativën e tyre për prezantimin e këtij problemi, u premtoi fëmijëve se rikonstruksioni i palestës së kësaj shkolle do të jetë një prioritet për vitin 2009. Ai u dhuroi fëmijëve edhe një set raketash tenisi, në mënyrë që fëmijët të ushtrohen në këtë lloj sporti duke shfrytëzuar edhe ambientet e ndërtruara në qytet për këtë qëllim.

Fjalën

e ke ti!

Komplimenta **Komente** **Ankesa**

Bashkia të ofron mundësinë të thuash atë që ti mendon mbi shërbimet e ofruara prej saj, sa pranë nevojave tuaja qëndrojnë ato dhe çfarë do të donit të bëhej më mire!

Ju mund të dërgoni **KOMPLIMENTE**, **KOMENTE** apo **ANKESA**

Ne kemi marrë përsipër t'ju sigurojmë shërbime sa më cilësore. Për këtë na duhet mendimi juaj. Nëse kemi bërë një punë të mirë apo jo, ne duam ta dëgjojmë këtë nga ju.

Fjalën e ke ti!

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Dorëzoni formatin e plotësuar pranë Zyrës së Informacionit "Bashkia Korçë"

Jepni sa më shumë informacion

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Të dhënat tuaja (jo e detyrueshme)

Emër Mbiemër:

Profesioni:

Adresa:

Tel:

e-mail:

Zgjidhni opsionin

Komplimenta

Komente

Ankesa



Korça në dimër

Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori
Benila Tërova

Ndihmuan:


Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës “V.Mio”
Ndërmarrja e Shërbimeve
Publike
Teatri “A.Z.Çajupi”

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Alketa Zallëmi

Design:

R&T Advertising



Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një këthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni “Qyteti Im”

Për më tepër informacion:

Tel: 457-55

e-mail: bashkiko@albmail.com

ëëë.bashkiakorçe.gov.al

